



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 329/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Alenca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit dhe dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2200 (dymijedyqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Subjekti politik AKR, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDD, ka bërë shkelje të, Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke e mbuluar posterin e subjektit politik AKR, me posterin e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik LDD.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 06.12.2010, nga subjekti politik AKR, në të cilën theksohet se subjekti politik LDD e ka mbuluar posterin e subjektit politik AKR, me posterin e kandidatit të tyre për deputet në Republikën e Kosovës, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikë së Kosovës nga radhët e subjektit politik LDD, është vendosur mbi posterat subjektit politik AKR. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDD, më datë 06.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.12.2010, gjerë në ora 16:00. PZAP-i, më datë 07.12.2010, pranoi përgjigjeje në ankesë nga kandidati për deputet i subjektit politik LDD, në të cilën theksohet se:

vendosjen e posterit në fjalë nuk e kanë bërë kandidatët e këtij subjekti politik, sipas parashtruesit të përgjigjeje në ankesë i cili potencon se ka qenë zyrtar i lartë për media në AKR dhe të gjithë posterat, sipas parashtruesit në përgjigjeje në ankesë janë vendosur me ngjitës të bardhë, andaj konsiderojnë se kjo është një hakmarrje për largim nga subjekti i lartcekur politik dhe po ashtu konsideron se një foto e tillë të cilës i mungon identifikimi i të vendosurit të posterit konsiderohet si e pabazë, sipërfaqësore dhe e papranueshme për këtë subjekt politik.

Përgjigjes në ankesë kandidati i subjekti politik LDD i ka bashkangjitur pesë fotografi, mirëpo asnjëra nuk ka të bëjë me rastin në fjalë, prandaj nga kjo del se ky subjekt politik nuk ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Neni 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i kandidatit për deputet në Kuvendi e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik LDD, është vendosur mbi posterin e subjektit politik AKR. Prandaj nga arsyet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim më dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 329/2010 më datën 08.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

